


Vizita me video të MyChart në NYC Health + Hospitals!

MyChart është portali ynë i pacientëve në NYC Health + Hospitals që ju jep akses elektronik në të dhënat tuaja shëndetësore, 24/7. Ne e përdorim gjithashtu MyChart për të ofruar vizita me video që të mund të merrni kujdes shëndetësor nga shtëpia. Mësoni më shumë më poshtë!

Vizitë me video me smartfonin/tabletën tuaj: Përdorni aplikacionin MyChart!

Nëse planifikoni të përdorni smartfonin/tabletën tuaj për vizitën me video, **duhet** të shkarkoni aplikacionin MyChart për të marrë pjesë në vizitën me video.

1. Duke përdorur kamerën e smartfonit, skanoni kodin QR më poshtë për të shkarkuar **aplikacionin MyChart** falas:






2. Hapni aplikacionin dhe identifikohuni në llogarinë tuaj të **MyChart**.




Vizita me video të MyChart në NYC Health + Hospitals!


3. Klikoni në ikonën **Visits (Vizitat)**. Në vijim klikoni te **Video Visit (Vizitë me video)** dhe butoni **Begin Visit (Filloni vizitën)** për t'u futur në vizitën me video.




4. Mund të shfaqet një dritare që pyet nëse programi mund të 'përdorë mikrofonin tuaj'. Zgjidhni "**Allow (Lejo)**" ose "**Yes (Po)**". Kjo do të lidhë mikrofonin e telefonit tuaj që ofruesi juaj të mund t'ju dëgjojë gjatë vizitës me video.
5. Mund të shfaqet një dritare tjetër që kërkon 'akses te videoja apo kamera juaj'. Zgjidhni "**Allow (Lejo)**" ose "**Yes (Po)**". Kjo do të lidhë kamerën tuaj në mënyrë që ofruesi të mund t'ju shohë gjatë vizitës.
6. Ju do të hyni në një dhomë pritjeje ndërsa mjeku përfundon me pacientin e mëparshëm. Mjeku do të shohë që jeni në dhomën e pritjes virtuale dhe do të bashkohet me ju së shpejti!



4.




5.



6.

Vizita me video të MyChart në NYC Health + Hospitals!

7. Ndërsa jeni duke pritur, kontrolloni lidhjen e videos/zanore duke përdorur butonat në 'dhomën e pritjes së ofruesit' (Provider's waiting room).




1. Për të konfirmuar nëse e keni gati **Kamerën**, klikoni në butonin Camera (Kamera) në të majtë lart
2. Për të provuar **Video**, klikoni në butonin Video (Video) për të fshehur ose aktivizuar/çaktivizuar videon tuaj. Kjo është një provë për t'u siguruar që videoja funksionon.
3. Për të provuar **Mikrofonin**, klikoni në butonin Microphone (Mikrofon). Flisni dhe shikoni nëse ka dridhje të linjës zanore kur flisni.
4. Për të provuar nëse ju punon **Altoparlanti**, klikoni në butonin e zi Speaker (Altoparlant) dhe dëgjoni për tingullin "ping".

Vizitë me video duke përdorur kompjuterin tuaj: Përdorni një shfletues të mbështetur!


(SHËNIM: Internet Explorer NUK punon me vizitat me video)

- [Chrome](#)
 - [Firefox](#)
 - [Safari](#)
1. Identifikohuni në llogarinë tuaj të **MyChart**, shkoni te menyja **Visits (Vizita)** dhe zgjidhni Vizitën tuaj me Video nga lista e takimeve të ardhshme, klikoni **Details (Detaje)**, më pas klikoni **Begin Video Visit (Filloni Vizitën me Video)**.



Vizita me video të MyChart në NYC Health + Hospitals!

2. Mjeku do të shohë që jeni në **dhomën e pritjes së Ofruesit (Provider's waiting room)** dhe do të bashkohet me ju së shpejti!
3. Ndërsa jeni duke pritur, kontrolloni lidhjen e videos/zanore duke përdorur butonat në dhomën e pritjes së Ofruesit.



1. Për të konfirmuar që **Kamera** është gati, klikoni në butonin Camera (Kamera) në të majtë lart.
2. Për të provuar **Video**, klikoni në butonin Video (Video) për të fshehur ose aktivizuar/çaktivizuar videon tuaj. Kjo është një provë për t'u siguruar që videoja funksionon.
3. Për të provuar **Mikrofonin**, klikoni në butonin Microphone (Mikrofon). Flisni dhe shikoni nëse ka dridhje të linjës zanore kur flisni.
4. Për të provuar nëse ju punon **Altoparlanti**, klikoni në butonin e zi Speaker (Altoparlanti) dhe dëgjoni për tingullin "ping".